

KONKURS PËR PRODHIM MEDIATIK

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (Soros) në Tiranë, në kuadër të **Programit të Medias**, me qëllim nxitjen e një mbulimi më të gjerë të çështjeve social-ekonomike të komuniteteve të papërfaqësuar, si dhe promovimin e punës të rinjve dhe formave të reja të medias qytetare, shpall **konkursin për prodhimin e video-dokumentarëve prej 5-12 minuta**, me **tematikë sociale** nga i gjithë territori i Shqipërisë.

Disa nga **tematikat** e sugjeruara, por jo vetëm :

- Aktivizmi dhe roli i lëvizjeve qytetare në zhvillimet e shoqërisë shqiptare
- Ekspozim dhe investigim i padrejtësive sociale, ekonomike si dhe shkelje të të drejtave civile dhe politike të qytetarëve .
- Investimet në ekonomi/ infrastrukturë dhe impakti i tyre në Mjedis
- Shëndeti publik dhe qytetari shqiptar
- Qyteti im/ lagja ime; Kulturat suburbane – arti, sporti e të tjera forma angazhimi qytetar
- Reformat dhe pasojat sociale

Ftohen të konkurrojnë si gazetarë e regjizorë të rinj, ashtu edhe të tjerë të rinj të apasionuar pas gazetarisë e videos. Konkursi do të jetë i hapur ndaj çdo **prodhimi** alternativ (larg qasjeve konvencionale të medias tradicionale) si në formën e paraqitjes ashtu edhe në përmbajtje, të ardhur nga të rinj, profesionistë apo amatorë.

Përparësi do të kenë **videot advokuese** mbi të drejta social ekonomike, **dokumentarët investigativë**, **videot me pjesëmarrje** (ku vetë komuniteti përfshihet në konceptimin dhe realizimin e videos)

Janë të mirëpritura format dhe teknikat e reja në filmim dhe montazh. Inkurajohet përdorimi i animacionit, inskenimit, fotografisë (still photography film) apo videos grafike (motion graphic).

*Këtë vit do të ketë edhe një seksion të vecantë aplikimi : “**Dy minuta**” - projektuar për nxënësit e shkollave të mesme. Ftohen të aplikojnë nxënës nga i gjithë vendi për realizimin e videove të shkurtra për të sjellë një dëshmi, opinion, qëndrim apo reflektim të tyre mbi atë cka i rrethon në jetën e përditshme. Videot e këtij seksioni do të jenë vetëm dy minuta të gjatë.*

Mënyra e aplikimit:

Aplikuesit mund të jenë **individë** ose **grupe individësh**.

Të gjithë të rinjtë e interesuar duhet të dorëzojnë një ‘skenar’ (koncept ide) të video- dokumentarit sipas **Formatit të Aplikimit** që gjendet duke klikuar ketu :

Këtë Format mund ta tërheqin edhe pranë zyrave të Fondacionit Soros në Tiranë, me adresë :

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë;

Rr. Qemal Stafa 120/2, Tiranë
Tel: +355-42235856, 42248213

Afafti i aplikimit është data 23 Qershor 2016

Aplikimet mund të dërgohen nëpërmjet postës elektronike te adresa **konkurs@osfa.al**, ose të dorëzohen te adresa e Fondacionit Soros në Tiranë.

Për më tepër informacion shkruani te adresa e emailit: konkurs@osfa.al